

PROGRES-i Evropian Raporti fillestar

CRIS numri 2014/342-561, IPA 2013, Serbi

Qëllimi kryesor: Kontributi ndaj zhvillimit të qëndrueshëm të juglindjes dhe jugperëndimit të Serbisë përmes avancimit të koordinimit në mes të nivelit nacional dhe lokal të pushtetit, krijimi i ambientit më të përshtatshëm për punësim, biznes dhe përmirësimi i infrastrukturës dhe avancimi i menaxhimit të mirë dhe përfshirjes sociale.

Qëllimi: Avancimi i nivelit lokal të menaxhimit, përmirësimi i kushteve për zhvillim të infrastrukturës, kapaciteteve më të mira për planifikim dhe menaxhim, ambient i avancuar për biznes si dhe mbështetja e zhvillimit të politikave të përfshirjes sociale dhe punësimit.

Buxheti i përgjithshëm: 17,46 milion euro

Data e fillimit: 19 maj 2014.

Data e përfundimit: 31 tetor 2017.

Komunat e përfshira në

program: Novi Pazari, Ivanjica, Nova Varosh, Priboji, Prijepolje, Rashka, Sjenica dhe Tutini në Serbinë jugperëndimore

Prokuplje, Blace, Zhitragja, Kurshumlia në Qarkun e Toplicës

Leskoci, Bojniku, Vlasotince, Lebane, Medvegja dhe Crna Trava në Qarkun e Jabllanicës

Vranja, Bosilegradi, Bujanoci, Vladicin Hani, Presheva, Surdulica dhe Trgovishta në Qarkun e Pcinjës

Brus në Qarkun e Rasinës

Aleksinci, Gaxhin Han, Doljevci, Meroshina dhe Svrlijigu në Qarkun e Nishit

Babushnica, Bela Palanka në Qarkun e Pirotit

Knjazhevcu në Qarkun e Zajecarit

Donatorët: Unioni Evropian
Qeveria e Zvicrës
Qeveria e Republikës së Serbisë

Partneri implementues: Zyra e Kombeve të Bashkuara për shërbime të projekteve (UNOPS)

Data e raportimit: 16 tetor 2014.

Periudha e raportimit: 7 maj 2014 – 16 shtator 2014.

Përmbledhje

Implementimi i PROGRES-it Evropian ka filluar pasi që Unioni Evropian (EU) dhe Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC) kanë nënshkruar marrëveshjet për ndarjen e mjeteve me agjencinë e cila e implementon programin- Zyrën e Kombeve të Bashkuara për shërbime të projekteve (UNOPS)- më 7 maj, respektivisht 16 qershor, 2014. Fillimi zyrtar i programit është shënuar me solemnitetin e mbajtur në Novi Pazar, më 25 qershor, ku kanë marrë pjesë përfaqësuesit më të lartë të donatorëve, të Qeverisë dhe faktorë të tjerë. Për të mos pasur pauzë në mes të implementimit të programit paraprak EU PROGRES-it, menaxheri i Qendrës së projekteve të UNOPS-it në Serbi ka lejuar pagesën e të punësuarve, shpenzimeve të rregullta, shpenzimet e përdorimit të automjeteve dhe qiranë e zyrave si dhe prokurimin e materialeve nga 1 prill deri më 6 maj, 2014, nga buxheti administrativ i UNOPS-it në Serbi, në shumë të përgjithshme prej 55.447 euro.

Është planifikuar që punëtoria fillestare, e cila paraqet një nga mundësitë kryesore për revizionin e dizajnit dhe modalitetit të zbatimit, të mbahet gjatë verës. Por, Qeveria dhe bashkësia e donatorëve kanë qenë të orientuara posacërisht në zvogëlimin e dëmit të shkaktuar nga vërshimet të cilat kanë ndodhur në Serbi në muajin maj, 2014. Me aprovimin e Delegacionit të BE-së, një pjesë e ekipit themelor të PROGRES-it Evropian është angazhuar që të mbështesë Qeverinë në hartimin e projektit për përgjigje ndaj dëmit të shkaktuar nga vërshimet i cili do të financohet nga BE. Për arsye se nuk ka qenë e mundur të mbahet punëtoria fillestare, por edhe për të harmonizuar periudhat fillestare me BE-në dhe SDC-në, në marrëveshje me dy donatorët e programit, periudha fillestare është vazhduar deri më 16 shtator, përderisa punëtoria fillestare është caktuar të mbahet në mes të tetorit, 2014. .

Përkundër kësaj, Programi ka arritur të realizojë të gjitha qëllimet e definuara në periudhën fillestare.

Së pari, përmes 135 takimeve, janë vendosur marrëdhënie me ministritë relevante, institucionet nacionale, vetqeverisjet lokale, donatorët dhe faktorët tjerë, kurse përmes bisedave për aktivitetet programore, është vërtetuar se janë planifikuar intervenime **në pajtim me politikat relevante nacionale dhe përgjigjen në nevojat e rajonit të përfshirë**. Për shembull, bashkëbiseduesit nga vetqeverisjet lokale kryesisht kanë identifikuar papunësinë si problem kryesor në bashkësitë e veta, kurse gjithashtu edhe kanë përshëndetur aktivitetet të cilat do të kontribuojnë në krijimin e ambientit më të përshtatshëm për investime dhe zhvillimin e biznesit. Infrastruktura e keqe dhe e lënë pas dore gjithashtu është identifikuar si një nga pengesat kryesore për zhvillim ekonomik dhe mbështetja në këtë fushë, kurse mbështetja në këtë fushë konsiderohet shumë e rëndësishme.

Megjithkëtë, në disa raste, komunat kanë treguar mosinteresim si dhe mosgadishmëri për realizimin e aktiviteteve në fushën e barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale. Përveç heqjes së Administratës për barazi gjinore në prill të vitit 2014, është rritur rreziku që mekanizmat lokale të barazisë gjinore (MRR) të mbetetn pa përkrahje profesionale dhe të reformohen dhe të lënë misionet dhe detyrat e veta. Gjithashtu nevojiten resurse shtesë që të avancuar kuptueshmërinë e dhe pranimin e këtyre koncepteve. Programi rekomandon vazhdimin e angazhimit të UN Women, për të siguruar jo vetëm

ekspertizë lidhur me çështjet e barazisë gjinore, por edhe për të përfshirë rrjetin e gjerë të faktorëve relevant në këtë fushë, që do të sjellë deri te realizimi i përpjekjeve në kuadër të programit.

Përvec kësam të drejtat e njeriut të grupeve të rrezikuara dhe të marginalizuara gjithmonë kanë prioritetin më të madh gjatë krijimit dhe realizimit të aktiviteteve programore. Ekspertizë e posacme dhe udhëzimet për çështjet e të drejtave të njeriut të cilat i ofron Zyra e komesarit të lartë të Kombeve të bashkuara për të drejtat e njeriut (OHCHR) ka shtuar kualitet të caktuar ndaj programit, jo vetëm përmes përfshirjes së shembujve të praktikave të mira, por edhe përmes qasjeve dhe rekomandimeve nga pikëpamja e të drejtave të njeriut në krahasim me raportimin programor.

Qëllimi i dytë i periudhës fillestare, vendosja e **organizimit të programit**, me sukses është realizuar: janë punësuar anëtarët e ekipit themelor dhe është formuar Këshilli Drejtues i Programit (UOP). UNOPS ka investuar përpjekje serioze që në mënyrë shtesë të avancojë ekipin e PROGRESit Evropian përmes trajnimeve në fushën e menaxhimit të projekteve dhe infrastrukturës, prokurimeve si dhe për çështjet operative në fushën e resurseve njerëzore. Është hapur zyra e re në Nish, përderisa programi gjithashtu ka edhe zyrat në Beograd, Novi Paza dhe Vranjë.¹

PROGRES-i Evropian ka shfrytëzuar periudhën fillestare që të revidojë supozimet themelore dhe rreziqet si dhe të vendos qasje sistematike ndaj menaxhimit të rreziqeve, që duhet të zvogëlojë efektet negative që mund të kenë ndodhitë e caktuara në realizimin e qëllimeve programore. Qasje më sistematike gjithashtu është vendosur në fushën e planifikimit dhe komunikimit, në pajtim me udhëzimet dhe kornizat e UNOPS-it të definuara përmes PRINC2 (projektet në ambiente të kontrolluara eng. *Projects IN Controlled Environments*) dhe metodologjitë MSP (menaxhimi i programeve të suksesshme, eng. *Managing Successful Programmes*).

Përvec sistemeve ekzistuese për përcaktimin e kualitetit të biznesit, PROGRES-i Evropian përgatit procedurat interne për përcaktimin e kualitetit si dhe sistemin për përcjelljen e dobive. Kjo është pjesë e menaxhimit të ndryshimeve brenda Qendrës për Projekte të UNOPS-it në Serbi dhe ka për qëllim që të sigurojë efikasitet dhe efektivitet të përdorimit të fuqisë punëtore dhe mjeteve në projekte të cilat i financojnë donatorët, që përfshin edhe themelimin e Zyrës për menaxhim të projekteve (KPM).

Dhe së treti, kanë realizuar disa **rezultate** konkrete lidhur me **aktivitetet** e PROGRES-it Evropian: vendosja e kriterëve dhe dokumentacionit për konkurset për propozim projekte në partneritet me organizatat e shoqërisë civile dhe vetqeverisjeve lokale dhe për përkrahjen e administratave të tatimore lokale; përfundimi i përshkrimeve të punës dhe obligimeve (PPO) për vlerësimin e menaxhimit në nivel lokal; hartimi i projekteve të përkrahjes kryesore të Programit të bashkëpunimit ndërkufitar Serbi- Mali Zi; asistenca teknike iu është siguruar Zyrës së Qevrrisë së Serbisë për Integritime Evropiane (SEIO) për hartimin e udhëzimeve për propozime të projekteve të infrastrukturës përmes Sektorit për kontraktim dhe financim të projekteve nga mjetet e BE-së (CFCU); kurse bashkëpunimi me Odën Inxhinierike të Serbisë është formalizuar me nënshkrimin e marrëveshjes për bashkëpunim. Gjithashtu janë vendosur marrëdhënie me iniciativën e përkrahjes në përgatitjen e

¹ Këto tri zyre janë hapur gjatë programit paraprak të PROGRES-it Evropian – EUPROGRES-it.

projekteve *Project Preparation Facility 5 (PPF5)*, që është me rëndësi për identifikimin e projekteve të cilët do të jenë të përkrahur gjatë programit.

PROGRES-i Evropian gjithashtu ka kontribuar në realizimin e marrëveshjes në mes të Komunës së Bujanovit dhe Fakultetit Ekonomik të Suboticës të Universitetit në Novi Sad për qiramarrje afatgjate të ndërtesës e cila do të ndërtohet në kuadër të programit. Edhe pse edhe më tutje duhet të zgjidhen çështjet lidhur me parcelën para se të fillojë ndërtimi, kjo marrëveshje paraqet një përparim të madh.

Ky raport, përveç pasqyrës së përgjithshme, përmban edhe detaje për rezultatet e realizuara gjatë periudhës fillestare, kontekstin programor, informata lidhur me aktivitetet kryesore dhe realizimet si dhe çështjet lidhur me menaxhimin e programit. Ai përmban informata për rreziqet dhe supozimet dhe rekomandimet për modifikime të vogla të aktiviteteve të planifikuara si dhe indikatorëve, posacërisht në fushën e barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut, klasterëve dhe përkrahjen e të rinjve nga bashkësia shqiptare në të mësuarit e gjuhës serbe.